



MUZA COMPETITION

FAZA 1

“MUZA COMPETITION” është një projekt i ndërmarrë nga Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon, i cili përfshin aktivizimin e të rinjve pasionantë dhe profesionistë, në rijetëzimin e elementeve etnografikë në fushën e fashion-dizajnit. Projekti i dedikohet të rinjve nga mosha 18-35 vjec nga gjithë qytetet shqipfolëse të rajonit të Ballkanit Perëndimor, për t’u ofruar atyre një spektër më të gjerë mundësish profesionale që synojnë nxitjen e punësimit në ekonomitë krijuese, nxitjen e krijimit të bizneseve start-up në këtë fushë, apo zgjerimin e bizneseve ekzistuese.

Nga gjithë jehona, sukcesi dhe energjia e papërshekrueshme e edicionit të parë, ne rikthehemi me një edicion të dytë, gjithmonë me të njejtin qëllim: promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë tonë kulturore, por tashmë me një eksperience nga viti i shkuar që na përgatit për një spektakël akoma edhe më të madh.

Prandaj, nëse je një i ri nga mosha 18-35 vjec dhe je i apasionuar pas fashion dizajnit, apliko tani për të prezantuar koleksionin tënd modern me elementë të traditës në Muza Competition, ku një juri e përbërë nga personalite të shquara në fushën e artit dhe dizajnit do të vlerësojnë më të mirin në eventin final që do të mbahet në muajin Qershor.

Tani është koha për të plotësuar dokumentat për të aplikuar dhe për të hyrë menjëherë në punë për të dërguar të gjitha skicimet **deri më 24 MARS, ora 16:00 PM në muzacompetition@gmail.com**.

Kriteret për aplikim

1. Të rinj të moshës **18-35 vjec** nga qytetet shqipfolëse të rajonit të Ballkanit Perëndimor;
2. Dorëzimi i skicave me veshjet të cilat duhet të përmbajnë si **tematikë kryesore elemente të etnografisë dhe trashëgimisë kulturore të qyteteve të ndryshme nga rajoni shqipfolës**, duke u bazuar në specifikat e detajuara si më poshtë:
 - Një portofol me një minimum prej **15 skicash** të veshjeve për të treguar konceptin tuaj fillestar të dizajnit në format A4. Për cdo skicë, ju duhet të përshkruani shkurt materialet që mendoni të përdorni për realizimin e saj.
 - Dizajnet tuaja do të vlerësohen në disa kategori; përdorimi i elementëve të trashëgimisë kulturore, metodat e përdorura për prodhimin e dizajneve, kreativiteti dhe origjinaliteti, qëndrueshmëria, tregtueshmëria.
 - **Çdo veshje duhet të jetë veshje komplet.**
 - Këpucët dhe aksesorët nuk kërkohen të dizajnohen, por do t'ju duhen për të siguruar këpucë/aksesorë për koleksionin tuaj kur të arrini në fazën e tretë finale.
 - **Krijimet duhet të jenë origjinale** dhe që nuk janë publikuar apo përdorur më parë.
 - Asnjë veshje **nuk kërkohet të prodhohet në fazën e parë dhe te dytë** të aplikimit.
 - 10 Finalistët e Edicionit të parë të MUZA COMPETITION **nuk mund të aplikojnë sërish** në edicionin e dytë.

Dokumentat që ju kërkohet të paraqisni:

1. Kartë identiteti të aplikantit;
2. CV
3. **Formulari i aplikimit** sipas formës së kërkuar në faqen e aplikimit;
4. Dorëzimi i **15 skicave të veshjeve** për të treguar konceptin tuaj fillestar të dizajnit.